

VENDIM
Nr. 315, datë 12.12.2025

MBI DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN E BORDIT TË ERE-s NR. 227, DATË 28.10.2024, “MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË ‘ALBANIAN POWER CORE’ SHPK, NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGIJISË ELEKTRIKE”

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të nenit 113, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; si dhe të nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 12.12.2025, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Politikave të Burimeve të Rinovueshme, me nr. 2844/3 prot., datë 25.11.2025, “Mbi disa ndryshime në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 227, datë 28.10.2024, ‘Mbi licencimin e shoqërisë ‘Albanian Power Core’ sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike””,

konstatoi se:

1. Të dhëna mbi shoqërinë “Albanian Power Core” sh.p.k.

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 227, datë 28.10.2024, ka licencuar shoqërinë “Albanian Power Core” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik me kapacitet prodhues 40.56 mw, në fshatin Sheq Marinas, Bashkia Fier, qarku Fier, për një afat 25-vjeçar.

- Në pikën 2, të vendimit nr. 227/2024, është përcaktuar se shoqëria duhet të fillojë ushtrimin e veprimtarisë së prodhimit të energjisë elektrike jo më vonë se data 27.3.2027.

- Në pikën 3 është përcaktuar se shoqëria duhet të dokumentojë fillimin e punimeve për ndërtimin e centralit fotovoltaik brenda afatit të fundit të vlefshmërisë së VNM-së paraprake (brenda datës 7.12.2024) ose të depozitojë në ERE një VNM paraprake të re në rast të mosfillimit të punimeve brenda kësaj date.

- Në pikën 4 është përcaktuar se, para vënies në operim, shoqëria duhet të risjellë marrëveshjen e lidhjes me OST-në me atë kapacitet prodhues sipas kontratës së nënshkruar me Autoritetin Kontraktor.

- Pika 5 e vendimit parashikon se ky vendim është objekt rishikimi nga ERE në kuadër të pikave 2, 3 dhe 4 të tij.

2. Korrespondenca dhe dokumentacioni i administruar

- Nga raportimet periodike të shoqërisë “Albanian Power Core” sh.p.k. është bërë me dije se shoqëria ka qenë në pritje të zbardhjes së lejes së ndërtimit për fillimin e punimeve të centralit fotovoltaik dhe se gjatë vitit 2025 ka rinovuar vlerësimin e ndikimit në mjedis (VNM paraprake).

- ERE, me shkresën nr. 2844 prot., datë 13.11.2025, ka kërkuar informacion lidhur me statusin aktual të punimeve për ndërtimin e centralit fotovoltaik dhe, në rast të mosfillimit të punimeve brenda datës 0.12.2024, ka vënë në dukje detyrimin e shoqërisë për të paraqitur një VNM paraprake të re, për shkak të humbjes së vlefshmërisë së VNM-së së depozituar më parë në ERE.

- Shoqëria “Albanian Power Core” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 2844/1 prot., datë 14.11.2025, ka njoftuar mbi fillimin e punimeve të parkut fotovoltaik me kapacitet 40.56 mw duke filluar nga data 24.11.2025, bazuar në lejen e ndërtimit nr. 1493/13 prot., datë 5.11.2025, miratuar me vendimin nr. 58, datë 25.9.2024, të KKT-së. Bashkëlidhur njoftimit janë depozituar kontratat përkatëse të sipërmarrjes për ndërtimin dhe supervizimin e punimeve.

- Gjithashtu, me *email*-in e datës 18.11.2025, drejtuar adresës zyrtare të ERE-s dhe protokolluar në ERE me nr. 2844/2 prot., datë 18.11.2025, shoqëria ka depozituar dhe VNM-në paraprake të rinovuar.

- Kjo VNM paraprake është lëshuar nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM) më datë 28.1.2025, me nr. serie AN201220240006 dhe nr. komisioni 10, dhe sipas saj, nëse projekti nuk fillon zbatimin në terren brenda 2 vjetëve nga data e miratimit të vendimit për VNM paraprake, dokumenti konsiderohet i pavlefshëm dhe procesi duhet të rifillojë nga e para.

- Në përputhje me sa më sipër, njoftimi për fillimin e punimeve në datën 24.11.2025 rezulton të jetë brenda afatit 2-vjeçar të vlefshmërisë së VNM-së paraprake të rinovuar.

- Sa i përket pikës 4, të vendimit nr. 227/2024, shoqëria “Albanian Power Core” sh.p.k., me shkresën e datës 7.11.2024, protokolluar në ERE me nr. 1662/15 prot., datë 7.11.2024, ka përcjellë në ERE qëndrimin e “OST” sh.a., dhënë me shkresën nr. 7195/2 prot., datë 4.11.2024, ku “OST” sh.a. miraton në parim lidhjen me rrjetin e transmetimit të parkut fotovoltaiq Sheq Marinas me fuqi të instaluar 40.56 mw dhe përcakton specifikimet teknike dhe detyrimet e shoqërisë për realizimin e lidhjes.

- Megjithatë, deri në këtë vendimmarrje, nuk rezulton të jetë depozituar në ERE marrëveshja e lidhjes me rrjetin e transmetimit, e ndryshuar sipas kapacitetit prodhues të përcaktuar në kontratë, ndaj ky kusht vijon të mbetet në fuqi.

3. Analiza ligjore dhe vlerësimi

- Duke qenë se VNM-ja paraprake e rinovuar është lëshuar më 28.1.2025, me vlefshmëri 2-vjeçare, dhe shoqëria ka njoftuar fillimin e punimeve më 24.11.2025, rezulton se projekti ka filluar zbatimin në terren brenda afatit të vlefshmërisë së VNM-së paraprake.

- Në këto rrethana, kushti i vendosur në pikën 3, të vendimit nr. 227/2024, për dokumentimin e fillimit të punimeve brenda afatit të VNM-së paraprake ose depozitimin e një VNM-je të re, konsiderohet i përmbushur.

- Si rrjedhojë, pika 3 duhet të shfuqizohet, pasi nuk ka më funksion kushtëzues për vijimin e projektit.

- Ndërkohë, për pikën 4, duke qenë se marrëveshja e lidhjes me rrjetin e transmetimit, e ndryshuar sipas kapacitetit prodhues, nuk është depozituar ende në ERE, kushti vijon të mbetet në fuqi dhe monitorimi i tij mbetet i nevojshëm.

- Për pasojë, pika 5, e vendimit nr. 227/2024, e cila parashikon rishikimin e vendimit në kuadër të pikave 2, 3 dhe 4, duhet të ndryshohet, duke reflektuar shfuqizimin e pikës 3 dhe duke ruajtur rishikimin vetëm në lidhje me pikat 2 dhe 4.

4. Nevoja për ndryshimin e vendimit

- Në mbështetje të nenit 113, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, i cili parashikon se një akt administrativ mund të ndryshohet, shfuqizohet apo anulohet, kryesisht nga organi publik që ka kompetencë për ta nxjerrë atë, vlerësohet se:

- Pika 3, e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 227, datë 28.10.2024, duhet të shfuqizohet, pasi kushti për të cilin është vendosur është përmbushur;

- Pika 5, e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 227, datë 28.10.2024, duhet të ndryshohet, duke u formuluar si vijon: “Ky vendim është objekt rishikimi nga ERE, në kuadër të pikave 2 dhe 4 të këtij vendimi.”.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Pika 3, e vendimit të ERE-s nr. 227, datë 28.10.2024, shfuqizohet.
2. Pika 5, e vendimit të ERE-s nr. 227, datë 28.10.2024, ndryshohet si vijon: “Ky vendim është objekt rishikimi nga ERE, në kuadër të pikave 2 dhe 4 të këtij vendimi.”.

3. Drejtoria e Politikave të Burimeve të Rinovueshme të njoftojë shoqërinë “Albanian Power Core” sh.p.k., Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, “OST” sh.a. dhe “ALPEX” sh.a., lidhur me vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti